




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit - Komuna Prishtinë OE ankues: - NTP – Vlora - Prishtinë	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar BIBAJ – Ekspert shqyrtues i prokurimit 		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 259/19 të parashtruar nga OE NTP “Vlora”- Prishtinë		
Datë	13.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt. 29.05.2019, me nr. 259/19 të parashtruar nga OE NTP “Vlora”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me rekuizita sportive” me nr. të prokurimit: 616-19-860-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues –Komuna Prishtinë.
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues - NTP “Vlora”- Prishtinë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE NTP “Vlora”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me rekuizita sportive” me nr. të prokurimit: 616-19-860-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna Prishtinë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	03.06.2019	13.06.2019
Nënshkrimi i ekspertit	data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën. 29.05.2019, OE NTP “Vlora” - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Europrinty”shpk - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me Rekuizita Sportive” me nr. të prokurimit: 616-19-860-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues NTP “Vlora” – Prishtine.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues NTP “Vlora” – Prishtine. janë:

Neni 1-Qellimi
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve
Neni 60- Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 66.1- Përshtatshmëria Profesionale
Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 26.8 i UOPP-se- Tabela, pika k
Neni 29.8 i UOPP-se, pika 1
Neni 39 i UOPP- Sqarimi i Tenderëve
Neni 41 i UOPP- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE NTP “Vlora”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me rekuizita sportive” me nr. të prokurimit: 616-19-860-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna Prishtinë.

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05.'L-O68 dhe Ligjin Nr. 05 L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.

Ne duke qene ne dijeni se OE i rekomanduar per konnate nga AK/komisioni vleresues nuk ka realizuar kontrata per turnizime te ngjas.me/sportive me 17.05 pas pranimi te vendimit te AK dhe letres standarde Kemi kerkuar qasje ne dokumentet zyrtare tek AK dhe me 20.05. na eshte lejuar qasja ne oferten e OE te rekomanduar per kondatë dhe OE i trete me renditje apo i dyte i percjegjshem dhe kemi konstatuar se dy OE te lartecur jane te papergjegjshem pe katesisht nuk plotesojne keikesat e AK ne FDT lidhur me kapacitetin teknik dhe/ose profesioial, paraqesim argumentet per dy OE si ne vijim

Nga materiali i terhekur fizikisht ne zyren e prokurimit prane KK Prishtine me 20.05. konstatojme se OE i rekomanduar per kontrate nga AK ka paraqitur kontrata dhe faktura fiktive, jo-reale dhe te tjetersuara, per 4 kontratat e prezentuara ne listen e kontratave ne ANEKS 6 te DT ka te dhena jo-reaie.

Kete e kemi konstatuar duke u bazuar ne listen e projekteve/furnizimeve me material zyrtar te dorezuar nga ky OE ne projektin AQP- Furnizim me material zyrtar per nivelin qendror 7 lote,

Faktet si ne vijim:

Nga kontrata per furnizim me material sportiv kinse OE Europrinty ka furnizuar OE Mediatech me material zyrtar dhe sportiv pas verifikimeve dhe konstatimeve te bera shihet se fatura e bashkangjitur ne KK Prishtine nr 16-2 10-11-14 e dt. 29.02.2016. ne vlere 9183.00 ku pershkruhen 11 pozicioce artikuj sportiv nuk korespondon me faturen me nr te njejte te dates se njejte te dorezuar ne projektin e AQP-se, ne listen e bashkangjitur ne AQP fatura nr 16-210-11-14 e dt. 29.02.2016. ka vlere 3567.43 dhe pershkrimi eshte furnizim me material zyrtar (prove bashkangjitur ista e kontratave e dorezuar ne AQP nga OE ne fjale) Fatura/deshmia tjeter e bashkangjitur kontrates ne fjale me nr 16-210-11-22 e dt. 31.03.2016. me vlere 13,575.00 me permbjtje rekuizita sportive nuk korespondon me faturen e njejte te dates se njejte te dorezuar ne projektin e AQP-se, ne listen e bashkangjitur ne AQP fatura nr 16-210-11-22 e dt.31.03.2016. ka vlere 3772.60 dhe pershkrimi eshte furnizim me material zyrtar (prove bashkangjitur lista e kontratave e dorezuar ne AQP nga OE ne fjale) Faturat e leshuara per KK Obiliq nuk korespodojne me kontraten e paraqitur ne ANEKS 6 te DT, ne liste OE ka paraqitur daten e lidhjes se kontrates 22.06.2017. dhe skadimi 22.06.2018. ndersa faturat e bashkangjitura jane jashte kesaj periudhe, si ne vijim:

- fatura nr. 11181-210-001-18 dt. 27.11.2018. shuma 60.00
- fatura nr. 13462-210-001-18 dt. 13.12.2018. shuma 1192.00
- fatura nr. 3613-210-001-18 dt. 03.04.2018. shuma 2489.00 nuk korespondon me faturen me nr te njejte dhe date te njejte dorezuar tek projekti AQP- furnizim me material zyrtar ku e njejta "ature me nr 3613-210-001-18 dt. 03.04.2018. ka shume totale 984.40 dhe pershkrim furnizim me material zyrtar (prove bashkangjitur lista e kontrafave e dorezuar ne AQP nga OE ne fjale).
- fatura nr. 10709-210-001-18 e dt. 09.10.2018. shuma 377.00 jasht pedudhes 22.06.2017 - 22.06.2018. poashtu artikujt e pershkruar ne keto fatura nuk perkojne me specifikacionin e KK Obilic furnizim me material sportiv.... pasiqe ne kete aktivitet te prokur roit ka ofertuar kompania jone dhe jemi ne dijeni per lenden e kesaj kontrate.

Kontrata nr 3 e paraqitur ne aneks 6 nga OE i rekomanduar per kontrate furnizim me material sportiv e lidhur me office traee nuk mund te pranohet pasiqe eshte lidhur me 5janar 2015 dhe eshte jashte periudhes se kerkuar nga AK ne ! ...'T ku kerkohet deshmi gjatë tri viteve të fundit duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontratë omth 14 03.2016-14.03.2019.

Faturat e leshuar per KFOR-HQ poashtu nuk perkojne me kete aktivitet te prokurimit pasiqe ne shumicen prej ty'e nuk ka perfshirje te rekuizitave sportive:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesen e parashtruar nga OE NTP "Vlora"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me rekuizita sportive" me nr. të prokurimit: 616-19-860-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna Prishtinë.

Fatura nr 16-280-01-855 e dt. 05.05.2016. permban furnizim me derrasu te zeze per klasa, banka, karrige, tabela etj

Fatura nr 16-280-01-856 nuk mund te pranohet si furnizim i ngjashem pasiqe ka perfshirje furnizim me kamina di e biao me uje.

Duke mos dashur te leshohemi tutje ne secilen fature veq e veq ne kemi kerkuar nga AK qe ne harmoni me pershkrimin ne dosjen e tenderit ANEKS 6 ku thuhet se Autoriteti kontraktues ka te drejte te verifikojte te dhenat e paraqitura ne kete ANEKS dhe nese vertetohet. te verifikojte edhe njehere deshmite-faturat e lartecekura se a jane valide me nr te fatures. permbajtje te saj, shuma etj. siq eshte vepruar nga AK/komisioni vleresues ndaj kompanise sone gjate vleresimit te ofertave per aktivitetin e njejte vitin e kaluar kur jane kontaktuar disa institucione dhe eshte kerkuar te verifikohen referencat e kompanise sone!

Bazuar ne letren standarde per sqarim te tenderit derguar tek OE i rekomanduar per kontrate nga AK perkatesisht kerkesen nr. 4 ku kerkohet nga OE qe te dorezohen deshmi se paisjet sportive te ofruara jane ne harmoni me ato te kerkuara ne dosjen e tenderit:

OE ne fjale ka deshtuar te dorezoje deshmi tek AK/komisioni vleresues se paisjet e ofruara plotesojne standardet e kerkuara ne dosjen e tenderit si EN 12432, EN 914 etj, sipas dokumentacionit te cilin e kemi terhekur hard copy gjate qasjes ne dokumentet zyrtare ne zyren e prokurimit shihet se OE ne fjale ka dorezuar disa test raporte te cilat ka e skaduar poashtu nuk perkojne produktet per te cilat OE ka derguar deshmi me kete aktivitet te prokurimit siq sh het ne njerren prej certifikatave te paraqitura nga OE shenon test request safety of toys- lodra.(prove certifikata / test raporti: dorezuar nga OE)

Bazuar ne dokumentacionin e shikuar gjate qasjes ne dokumente zyrtare konstatojme se edhe OE tjeter pjesmarres ne kete aktivitet te prokurimit i nxjere si i pergjegjshem nga komisioni vleresues nuk ploteson kapacitetin teknik/profesional te kerkuar ne nenin 9.1&9.2 te FDT-se dhe plotesim ndryshimin e ngarkuar ne platforme nga AK me ane te formularit per ndryshime ne DT 14.03.2019. ku kerkohet:

1. Operatori ekonomik duhet te ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata per furnizime te ngjajshme (gjatë tri viteve të fundit duke f lluar nga data e publikimit te Njftimit për kontratë) jo më pak se 50,000.00€.

OE i dyte i pergjegjshem sipas komisionit \ ieresues NTG Blendi ka paraqitur deshmi (fatura&fletdergesa) per disa kontrata te paperfucduara, kontrata me Universitetin e Prishtines te cilen e ka paraqitur ne liste per te cilen jemi ne konzorcium me kompanine ne fjale eshte kontrate e pape-h.nduar dhe si e tille nuk duhet/mund te pranohet si deshmi.

Poashtu kontrata me KK Gracanice eshr. e paperfunduar eshte projekt ne proces dhe si e tille e paperTmduar nuk ploteson kerkesen c AK ne nenin 9.1&9.2 te FDT-se

Poashtu r,y OE ka bashkangjitur disa deshmi tjera fum me me mirenjohje, dekorata, maica, bilborda, fletushka. material reprezentai v etj te cilat nuk perkojne me kete aktivitet prokurimit dhe nuk arrijne vleren minimale prej 50,000.00 deshmi per se ka perfunduar me sukses kontrata per furnizime te ngjashme.

Te vetmet kontrata te cilat mund ti pranonen si valide OE ne fja e ane kontratat me KK Pushtine- furnizim me topa i shkollave ne vlere 5295.00 dhe kontrata me Sherbimin korrektues furnizim me rekuizita, artikuj sportv ne vlere 1265 00 mirepc vlere totale e tyre prej 6560.00 nuk ploteson kerkesen e AK qe te dorezohen deshmi mbi pertundlmin me sukses te Kontratave jmjngjashmcmminimum 50,000.00euro.

Prandaj bazuar ne faktet e lartecekura ne pajtim me nenin 69 te LPP-se dhe kriteret e vendosura ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit nga AK per kete aktivitet te prokurimit konstatojme se dy OE te iartecekur jane te papergjegjshem pasiqe nuk plotesojne kushtin/kriterin lidhur me kapacitetin teknik dhe ose profesional.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:	05. 03. 2019
Lloji i procedurës së aplikuar:.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....	Kontratë publike kornizë (12 muaj) , shërbim
Vlera e parashikuar e kontratës:.....	100,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Njoftimi për indoksim – permiresim i gabimit.....	11.03.2019
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	02.04.2019
Data e hapjes së ofertave.....	02.04.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....	14.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm.....	15.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim.....	22.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....	24.05.2019

Kriteret për vlerësim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuar në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rks-gov.net>

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1 Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , - Plotësimi i Aneksit Nr. 2 të Dosjes së Tenderit Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata - kërkohej origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentet të kërkuara në pikën 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, dhe të vazhdojë me shpërbllim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit në vendin e dytë të kështu me radhe.

II.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Regjistrimi i Numrit Fiskal për kompanitë vendore

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Kopja e certifikates se regjistrimit të biznesit me llojin e veprimtarive të regjistruara
2. Certifikata e numrit fiskal - kopje

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar NA

Dëshmia e kërkuar dokumentare AN

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të ngjajshme (gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë) jo më pak se 50,000.00€.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1.	“Kega” shpk & NPT “Mali”	Prishtinë	75 843.39 €	JO
2.	“Europrinty” shpk	Prishtinë	78 686.50 €	JO
3.	NTG “Blendi”	Prishtinë	93 808.80 €	JO
4.	NTP “Vlora”	Prishtinë	96 977.80 €	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Albina Bajrami – Kryetare e komisionit
- Arber Gashi – Anëtar i komisionit
- Liridona Krasniqi – Preniqi – Anëtare e komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit rekomandon për dhenje të kontratës OE-ik, “Europrinty” shpk, me çmimin me të ulet të përgjegjshëm prej 78.686,50 €.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues NTP “Vlora” – Prishtinë.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE NTP “Vlora”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me rekuizita sportive” me nr. të prokurimit: 616-19-860-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna Prishtinë.

Sqarim Hyres: Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtinë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim (kornizë – 12 muaj) me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënje të kontratës, “Europrinty” shpk, si edhe OE NTG “Blendi”, i kualifikuar si i përgjegjshëm por i pa suksesshëm.

- Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës më datën 22.05.2019, ka paraqitur kërkesë për ri shqyrtim me pretendimet e njëjta ankimore të paraqitura si në ankesën e deponuar në OSHP. AK – Komuna Prishtinë më datën 24.05.2019, nxjerr vendim dhe refuzon të njëjtën kërkesë si të pa bazuar.

Përgjigjje në pretendimin ankimore 1 (neni 113) : Pretendimet kryesore ankimore kundrejt të dy OE-ve, të lartë përshkruar ndërlidhen me kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale, ku AK, (pas përmiresimit të gabimit) në piken 9.1, të FDT-s, ka kërkuar: *“OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për furnizime të ngjashme (gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) jo më pak se 50,000.00€”*. Për të njëjtën kërkesë si dëshmi dokumentare është kërkuar: *“Nje liste të kontratave të realizuara, duke plotësuar aneksin 6, të DT, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjitën referencat ose certifikatat për kryerjen e furnizimeve”*.

Pra, AK/ Komuna Prishtinë, përmes kërkesës ka potencuar se ofertuesit duhet të prezantojnë dëshmi për projekte të përfunduara gjatë tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë (05.03.2019).

- Përderisa operatori ekonomik i rekomanduar për dhënje të kontratës, në aneksin 6, të DT, ka përshkruar gjithsesë 4, projekte, me vlerë të përgjigjthëshme prej 101 650.20 €.
- AK përmes procesit të vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtesë nga i njëjti OE, dhe përmes përgjigjës i njëjti ka prezantuar kopje të faturave, ku përmes të cilave mbulohet vlera e kërkuar në dosje të tenderit, megjithatë kundrejt faturave të njëjta nuk janë prezantuar të gjitha kopjet e referencave. Konkretisht OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar, referencën e datës 05.01.2019, të lëshuar nga “Office Trade”, në vlerë prej 32,324.35 €, dhe referencën e datës 20.01.2018, të lëshuar nga “Mediatech” në vlerë prej 45 623.85 €, rrjedhimisht faturat e prezantuara kundrejt këtyre dy projekteve të përshkruara si të realizuara, nuk e mbulojnë vlerën e kërkesës së AK-së, ndërsa referencat tjera, ajo e Komunes së Obiliqit dhe Kforit, nuk janë prezantuar.

- **Përgjigjje në pretendimin ankimore 2** Në vijim po sqarojme pretendimet ankimore kundrejt

ofertes së OE NTG “Blendi”, i kualifikuar si i suksesëshëm.

- Sipas shkresave të lëndës së OE NTG “Blendi, rezulton që i njëjti përmes ofertës ka prezantuar listën e projekteve me gjithsej 5 projekte të realizuara, megjithatë si dëshmi dokumentare ka prezantuar referencën e datës 11.05.2017, të lëshuar nga SHKK- Ministria e Drejtësisë, në vlerë prej 1,265.50 €, si dhe disa kopje të faturave, ku përmes të cilave nuk vërtetohet se i njëjti e mbulon kërkesën e AK-së.

Shkeljet e konstatuara të LPP-s

Neni 59, LPP – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa nëse përgjatë seances dëgjimore eventuale, përfaqësuesit e AK-s, nuk prezantojnë provat: Referenca e Komunes së Obiliqit dhe Kforit, atëherë lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.